



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARIT TË KZAZ Nr. 33, SEKRETARIT TË KZAZ Nr. 33,  
SEKRETARIT TË KZAZ Nr. 35, SHKARKIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË SEKRETARIT TË  
KZAZ NR. 70, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30  
QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 16.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 33, sekretarit të KZAZ nr. 33, sekretarit të KZAZ nr. 35, shkarkimin dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 70, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 21, pika 11, neni 29, pika 5, neni 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe propozimet e paraqitura nga partia politike,

**V Ë R E N**

Partia Socialiste e Shqipërisë me shkresën nr.2310 prot., datë 11.04.2019, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.33, Qarku Tiranë, lirim dhe emërim të sekretarit të KZAZ nr.33, Qarku Tiranë, lirim dhe emërim të sekretarit të KZAZ nr.35, Qarku Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, i gjen ato në përputhje me kërkesat e nenit 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor.



**Nr. 172 Vendimit    Data 16.04.2019    Ora 12 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Për lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së 33, sekretarit të KZAZ 33, sekretarit të KZAZ 35, shkarkimin dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 70, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 141, datë 09.04.2019, plotësoi vakancën në KZAZ-në nr. 70, duke emëruar kryesisht në pozicionin e sekretarit Freskida Shullëri. Kjo shtetase nuk u paraqit në mbledhjen e thirrur të KZAZ nr. 70, në datë 11.04.2019, dhe nuk u arrit të kontaktohej në vijim. Për shkak të mosparaqitjes në detyrë të sekretarit të emëruar kryesisht, KZAZ nr. 70 ka ende vakant pozicionin e sekretarit. KQZ konstaton vakancën dhe bazuar në nenin 32, pika 1, gërma "c", të Kodit Zgjedhor, shkarkon nga detyra sekretarin e emëruar kryesisht dhe plotëson vakancën duke përzgjedhur nga lista e shtetasve të miratuar me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, shtetasin që plotëson kushtet e nenit 30 dhe 31, për emërimin kryesisht sekretar i KZAZ nr. 70.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 11, nenin 29, pika 5, nenin 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I:**

1. Të lirojë nga detyra anëtarin dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.1.
2. Të emërojë anëtarin dhe sekretarët e KZAZ-ve të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.2.
3. Të shkarkojë sekretarin e emëruar kryesisht të KZAZ nr. 70, sipas lidhjes nr. 1.
4. Të emërojë kryesisht sekretarin e KZAZ nr. 70 sipas lidhjes nr. 2.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 172 Vendimit    Data 16.04.2019    Ora 12 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Për lirimin dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së 33, sekretarit të KZAZ 33, sekretarit të KZAZ 35, shkarkimin dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 70, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019